



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D' Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)  
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

## RAPORT MONITORIMI

### MBI PROCEDURËN E HEDHJES SË SHORTIT PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI

**ZHVILLUAR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKES NË DATËN 04.12.2020**

Tiranë, Dhjetor 2020

## *Hyrje*

Avokati i Popullit, si institucion i pavarur, i parashikuar në Kushtetutë, për mbrojtjen, parandalimin e shkeljes dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të ligjshme të individëve, vlerëson Reformën në Drejtësi, si reformën më të rëndësishme për ecurinë dhe zhvillimin e sistemit demokratik në Shqipëri. Kjo reformë ka marrë fokus të vecantë në punën e institucionit të Avokatit të Popullit, jo vetëm për shkak të detyrimeve ligjore në përcaktuara në legjislacionin në fuqi, por edhe për shkak të vet rëndësisë që mbart kjo reformë, e lidhur drejtëpërdrejtë me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut në vend.

Në ushtrim të mandatit dhe detyrave bazë, të ndërthurura me kompetencat “atipike”, që i njihen nga Kushtetuta, Avokati i Popullit, konsiderohet si një ndër faktorët insitucionalë parësorë për garantimin e suksesit të zbatimit të kësaj reforme, që në vetvete mbart dy qëllime kryesore, luftën kundër “koorporatizmit” dhe transparencën e plotë në vendimmarrje si premisë për të garantuar meritokracinë në luftën ndaj pandëshkueshmërisë. Këto masa mëtojnë të sigurojnë besueshmërinë e pritshme dhe të nevojshme për sistemin e drejtësisë në vend.

Avokati i Popullit konsideron si jetësore për të gjithë shoqërinë shqiptare kthimin e besimit në sistemin e drejtësisë në vend dhe për këtë ka dhënë dhe vazhdon të japë kontributin e tij në monitorimin e shumë prej proceseve, të nevojshme për t’u realizuar, në kuadër të Reformës në Drejtësi.

Një vend të rëndësishëm në këto procese luan roli kushtetues i Avokatit të Popullit, në vëzhgimin aktiv dhe proaktiv të veprimtarisë së institucioneve që zhvillojnë procedurat e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), si dhe monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së këtij institucioni, në të gjithë spektrin funksional të saj. Ky rol përbën një risi dhe garanci të shtuar, për transparencën dhe rritjen e besueshmërisë së KED-së, si një prej organeve të reja, të krijuara për qeverisjen e sistemit të drejtësisë.

Në dritën dhe përgjegjësinë e lartë të këtij angazhimi institucional, vlerësojmë se pjesëmarrja dhe monitorimi i procesit të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së dhe për më tepër vlerësimi i raporteve të monitorimit, të përgatitura nga ana e Avokatit të Popullit, duhet të konsiderohen si pjesë e sistemit “check and balance” dhe të trajtohen problematikat, nëse ka, në kuadër të veprimtarisë së organeve që kanë përgjegjësinë dhe detyrimin e mbarëvajtjes së procesit të hedhjes së shortit, për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Duke vlerësuar maksimalisht përfshirjen e institucionit tonë si referencë në disa prej aspekteve të zbatimit të Reformës në Drejtësi, Avokati i Popullit thekson qëndrimin e tij se, pa një sistem drejtësie të pavarur, eficient dhe të drejtë, Shqipëria nuk do të ndërtojë dot një ekonomi konkurente që garanton investimet e brendshme dhe të huaja, një politikë të pastër, një jetë të sigurtë për qytetarët e saj, Shtetin e së Drejtës.

Në vijim po paraqesim raportin e monitorimit për procedurën e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të ushtrrojë veprimtarinë gjatë vitit 2021, të zhvilluar në datën 04.12.2020, në sallën “Skënderbej”, në institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

**1. Kompetenca e Avokatit të Popullit, për monitorimin e procedurës së shortit, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.**

Lidhur me procedurën e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, parashikon në pikën 3, të nenit 149/d, dhe në pikën 11, të nenit 179 (dispozitat kalimtare dhe të fundit), përkatësisht dhe ndër të tjera se:

*“Presidenti i Republikës për zgjedh me short, midis datave 1 dhe 5 Dhjetor të çdo viti kalendarik, anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED)<sup>1</sup> ... Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të zgjedhë anëtarët deri në datën 5 Dhjetor, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda datës 10 Dhjetor të atij viti kalendarik. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit, si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.*

*“Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e shortit, si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.*

Po kështu, në pikën 7, 10 dhe 11, të nenit 221 dhe në pikën 6, të nenit 284, të ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, parashikohet përkatësisht se:

*“Presidenti i Republikës, në prani të Avokatit të Popullit, për zgjedh anëtarët e Këshillit me short, midis datës 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik. Përveç anëtarëve të parashikuar në pikën 1, të nenit 220, të këtij ligji, Presidenti i Republikës zgjedh edhe një anëtar zëvendësues nga secili institucion në të njëjtin short”,*

*“Rezultatet e shortit dhe përmbledhja e e procesverbalit të procesit të shortit bëhen menjëherë publike në faqen zyrtare të internetit të Presidentit të Republikës”,*

*“Avokati i Popullit bën menjëherë publik në faqen zyrtare të institucionit raportin e monitorimit të procesit të shortit”.*

Përdorimi i terminologjisë “vëzhgues” dhe “merr pjesë”, për përcaktimin e kompetencës që, Avokati i Popullit ka në procesin e krijimit dhe në funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), është një çështje e rëndësishme dhe thelbësore, pasi roli i vëzhguesit është minimumi i kompetencës që Avokatit të Popullit, i njihet në këtë kuptim, karshi organit të pavarur, të KED-së. Ligji nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ka rimarrë dhe detajuar përcaktimet e dhëna më sipër në Kushtetutë, duke qartësuar se, Avokati i Popullit ka rolin dhe kompetencën e vëzhguesit, vetëm për procesin e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së.

---

<sup>1</sup> Sipas nenit 149/d, pika 1, të Kushtetutës përcaktohet se: “Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati”.

Objekti i veprimtarisë së KED-së, si një prej organeve shtetërore më të rëndësishme për qeverisjen e sistemit të drejtësisë, në përputhje me nenin 149/d, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, lidhet me verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

KED-ja me cilësinë e një organi kolegjal, përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 221/1, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Ata ushtrojnë detyrën me një mandat një vjeçar, që fillon në datën 1 Janar, të çdo viti kalendarik.

Përbërja e KED-së, përcaktohet në nenin 220, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me këtë përkatësi:

- 2 (dy) gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese,
- 1 (një) gjyqtar i Gjykatës së Lartë,
- 1 (një) prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme,
- 2 (dy) gjyqtarë nga Gjykatat e Apelit,
- 2 (dy) prokurorë nga zyrat e prokurorisë, pranë Gjykatave të Apelit,
- 1 (një) gjyqtar nga Gjykatat Administrative.

Sipas pikës 3, të nenit 220, dhe sipas pikës 7, të nenit 221, të po të njëjtit ligj, krahas anëtarëve të KED-së, zgjidhen edhe anëtarë zëvendësues të tyre, që zëvendësojnë të parët, në rast pamundësie ushtrimi të funksionit, ose në rast të konfliktit të interesit.

Presidenti i Republikës në ushtrim të kompetencës së tij, parësore kushtetuese dhe ligjore, për zhvillimin e procesit të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, midis datave 1 dhe 5 Dhjetor të çdo viti kalendarik, në respektim të afatit përcaktues kohor ka zhvilluar këtë proces, në datën 4.12.2020.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 149/d, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka nxjerrë Vendimin nr.413 datë 25.11.2020 “Për caktimin e datës për organizimin e procedurës për hedhjen e shortit, nga Presidenti i Republikës, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2021”, duke caktuar zhvillimin e procedurës së hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në datën 4 dhjetor 2020, ora 11.00”, në sallën “Skënderbej”, në institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Vendimi i sipërcituar dhe dokumenta të tjerë zyrtarë, të nevojshëm për realizimin e procesit të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2021, janë bërë publike, në njoftimin zyrtar të publikuar në faqen “on line”, të institucionit të Presidentit të Republikës, në rubrikën “Hedhja e shortit për KED – Shorti për KED 2021“, para kryerjes së procesit të hedhjes së shortit. Në respektim të parimit të transparencës për realizimin e procesit, vlerësojmë se njoftimi publik i kryer në këtë rast nga ana e Presidentit të Republikës, i ka shërbyer këtij qëllimi duke kontribuar gjithashtu në garantimin e ligjshmërisë, seriozitetit dhe besimit të publikut në këtë proces.

Në rubrikën përkatëse të faqes “on line”, të institucionit të Presidentit të Republikës, përmbahen gjithashtu edhe dokumentat zyrtarë që vërtetojnë kryerjen e procedurave përkatëse ligjore, mbi bazën e të cilave është organizuar shorti, si dhe dokumentacioni i përcjellë nga institucionet e ngarkuara nga ligji 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, për dërgimin e listave me emrat e kandidatëve, për anëtarë të KED-së.

Njoftimi zyrtar për këtë qëllim i është dërguar Avokatit të Popullit, zj. Erinda Ballanca, me shkresën nr.4076/2 datë 27.11.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit të Presidentit të Republikës. Shkresa e sipërcituar i është drejtuar gjithashtu, edhe Anëtarit me kompetenca të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, zj. Vitore Tusha, Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, zj. Naureda Llagami, si dhe Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Gent Ibrahim.

Procedura e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2021, është kryer gjithashtu në përputhje edhe me Rregulloren “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, të miratuar nga ana e Presidentit të Republikës, me vendimin nr.404 datë 25.11.2019. Vendimi i Presidentit të Republikës së bashku me rregulloren e sipërcituar, gjenden të publikuar në faqen “on line”, të institucionit të Presidentit të Republikës, fakt ky që veç kryerjes së një procesi transparent vërteton edhe përmbushjen e detyrimit ligjor, për miratimin e një rregulloreje të posaçme për procedurën e hedhjes së shortit, sikundër përcaktohet në nenin 149/d, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 221, pika 9, të ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”.

Kjo rregullore ka mbetur e pandryshuar që nga koha e miratimit të saj dhe sikurse kemi theksuar edhe në raportet tona të mëparshme të monitorimit, ajo qëllimon përcaktimin e procedurave dhe rregullave të hollësishme për organizimin e shortit, nga ana e Presidentit të Republikës. Nënshtrimi i procesit të hedhjes së shortit, respektimit të parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të tij, sikurse parashikohet shprehimisht në rregulloren “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në

Drejtësi”, vlerësojmë se përbën një garanci thelbësore, për të realizuar korrektësisht nga ana ligjore, shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Avokati i Popullit ka kompetenca të caktuara në këtë proces, të parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si dhe nga ligji nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, lidhur me:

- Monitorimin (vëzhgimin) e procedurës së hedhjes së shortit, për përzgjedhjen e anëtarëve të KED-së, nga ana e Presidentit të Republikës, duke hartuar dhe bërë publik një raport mbi monitorimin e kryer nga ana e tij.
- Pjesëmarrjen si vëzhgues në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (pas krijimit të tij).

Qëndrimi institucional i Avokatit të Popullit është se, parimet e transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të procesit të përcaktuara në pikën 9, të nenit 221, të ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, duhet të jenë efektive për të bërë të mundur si përcaktimin e kandidatëve të cilët do ti nënshtrohen shortimit, ashtu edhe procedurën e shortimit të kandidatëve për t’u bërë anëtarë. Kjo do të thotë se procesi fillon dhe zhvillohet efektivisht, jo vetëm mbi bazën e njoftimeve dhe nisjes së procedurave përkatëse ligjore nga ana e Presidentit të Republikës, por ai bazohet edhe në seriozitetin dhe integritetin moral dhe profesional, të emrave të propozuar si kandidatura për anëtarë të KED-së, nga ana e institucioneve përgjegjëse që kanë këtë detyrim, me qëllim që ky proces të jetë sa më përmbytësor dhe në përmbushje të plotë, të kriterëve të përcaktuara në ligj.

### ***3. Përmbushja e kriterëve ligjore nga kandidatët***

Neni 221, pika 1, e ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, përcakton tetë kriteret ligjore, që duhet të plotësojnë kandidatët për t’u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së, që do të funksionojë përgjatë vitit 2021.

Edhe në njoftimin zyrtar të publikuar në faqen “on line”, të institucionit të Presidentit të Republikës, nënvizohet kjo kërkesë bazike për vlefshmërinë e procesit. Në këtë njoftim ndër të tjera thuhet shprehimisht se, “...sipas ligjit do të përfshihen në short për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ata magistratë (gjuqtarë dhe prokurorë) dhe Gjuqtarë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët, plotësojnë kushtet e parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj”.

Në faqen zyrtare “on line”, të institucionit të Presidentit të Republikës, janë publikuar ndër dokumente të tjera zyrtare që lidhen me këtë proces, edhe:

- Shkresa nr.337 datë 13.11.2020, e anëtares me kompetencat e Kryetarit të Gjykatës së Kushtetuese, zj. Vitore Tusha, drejtuar Presidentit të Republikës, me anë të së cilës dërgohet lista e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara në ligj dhe kriteret ligjore për t'u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të KED, që do të funksionojë përgjatë vitit 2021.<sup>2</sup>
- Shkresa nr.1634 datë 16.11.2020, e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), drejtuar Presidentit të Republikës, me anë të së cilës dërgohet lista e prokurorëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore për t'u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të KED, që do të funksionojë përgjatë vitit 2021. Në listën e propozuar gjenden 9 (nëntë) prokurorë, në Prokurorinë e Përgjithshme dhe 9 (nëntë) prokurorë, në Prokuroritë e Apeleve. Në këtë shkresë bëhet me dije edhe fakti se, lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore për t'u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së, si dhe lista me kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore është publikuar në faqen zyrtare të KLP-së.
- Shkresa nr.5811 datë 13.11.2020, e Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), zj. Naureda Llagami, drejtuar Presidentit të Republikës, me anë të së cilës dërgohet lista me emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të Gjykatave të Apelit dhe gjyqtarëve të Gjykatave Administrative, të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore për t'u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të KED, që do të funksionojë përgjatë vitit 2021. Më konkretisht, në listën e dërguar gjenden, 3 (tre) gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, 13 (trembëdhjetë) gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Tiranë, 2 (dy) gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Durrës, 5 (pesë) gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, 1 (një) gjyqtar i Gjykatës së Apelit Korçë, 4 (katër) gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Shkodër, 6 (gjashtë) gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Vlorë, 5 (pesë) gjyqtarë të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krim të Organizuar, 9 (nëntë) gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Apelit, 1 (një) gjyqtar i Gjykatës Administrative Durrës, 1 (një) gjyqtar i Gjykatës Administrative Gjirokastër, 2 (dy) gjyqtarë të Gjykatës Administrative Korçë, 1 (një) gjyqtar i Gjykatës Administrative Vlorë dhe 15 (pesëmbëdhjetë) gjyqtarë të Gjykatës Administrative Tiranë.

Me anë të shkresës nr.4076/1 prot, datë 27.11.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit të Presidentit të Republikës, drejtuar Kryetarit të KLGJ-së, Kryetarit të KLP-së, si dhe për djepin, Avokatit të Popullit, bazuar në listat e kandidatëve të përfshirë nga ana e këtyre institucioneve për hedhjen e shortit për anëtarë të KED-së, kërkohet informacion për procedurat ligjore të ndjekura prej tyre, deri në këtë fazë paraprake të procesit. Më konkretisht, është kërkuar së pari, verifikimi

---

<sup>2</sup> Sipas kësaj shkrese lista e dërguar përmban emrat e 4 gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe më konkretisht: zj. Vitore Tusha, anëtare me kompetencat e Kryetarit të Gjykatës së Kushtetuese, Zj. Elsa Toska, gjyqtare, Znj. Marsida Xhaferllari, gjyqtare, dhe Zj. Fiona Papajorgji, gjyqtare.

në vijëmesi i plotësimit të kushteve dhe kriterëve nga gjyqtarët dhe prokurorët e përfshirë në listën e dërguar nga KLGJ-ja me shkresën nr.5811 prot, datë 13.11.2020 dhe listën e KLP-së, përcjellë me shkresën nr.1634 prot, datë 16.11.2020, deri në momentin e organizimit të shortit dhe dërgimin menjëherë të çdo të dhëne apo informacioni zyrtar. Kjo me qëllim që, në në momentin e organizimit të shortit në datë 4 Dhjetor 2020, të përfshiheshin në short ata kandidatë gjyqtarë dhe prokurorë të cilët plotësojnë ende kushtet dhe kriteret ligjore.

Në këtë shkresë të Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit të Presidentit të Republikës, është kërkuar informacioni për bërjen publike në faqen zyrtare të këtyre institucioneve të listave respektive të kandidatëve, që plotësojnë kushtet për anëtar të KED-së, procedurës së njoftimit me shkrim të kandidatëve të përjashtuar për shkak të mosplotësimit të kushteve për anëtar të KED-së. Është kërkuar informacion edhe mbi faktin, nëse ka patur ankesa pranë Gjykatës Administrative të Apelit nga ana e gjyqtarëve/prokurorëve të përjashtuar nga kandidimi me vendimin përkatës, si dhe nëse kishte apo jo, vendime përfundimtare të formës së prerë, nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, për këto ankime.

Me shkresën nr.4105 prot, datë 1.12.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit të Presidentit të Republikës, drejtuar Kryeinspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe për dijëni, Avokatit të Popullit, bazuar në listat e kandidatëve gjyqtarë që janë kualifikuar paraprakisht nga KLGJ-ja, për të marrë pjesë në short, si dhe në listat e kandidatëve prokurorë që janë kualifikuar paraprakisht për të marrë pjesë në short, nga KLP-ja, kërkohet informacion shprehimisht nëse:

*“Për ndonjë magjistrat që ushtron detyrën pranë gjykatave administrative, gjykatave të apelit, prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe Prokurorisë së Përgjithshme të përfshirë si kandidat në listat e dërguara nga ana e KLGJ-së (me shkresë nr.5811 prot, datë 13.11.2020) dhe nga ana e KLP (me shkresë nr.1634 prot, datë 16.11.2020), deri në momentin e organizimit të shortit (4.12.2020), ka filluar ndonjë procedim disiplinor, apo jo?”*

Në përgjigjen e kthyer me shkresën nr. 1694/3 prot, datë 3.12.2020, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit të KLP-së, është konfirmuar se, ky institucion ka bërë publike në faqen zyrtare “on line” të tij, listat e kandidatëve nga radhët e prokurorëve që plotësojnë kushtet ligjore për t’u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të KED, si dhe lista e kandidatëve që nuk plotësojnë këto kushte. Në vazhdim konfirmohet se, kandidatët që nuk plotësonin kushtet dhe kriteret ligjore për këtë qëllim (7 prokurorë), janë njoftuar individualisht lidhur me këtë vendim. Në përmbajtjen e kësaj shkrese jepet informacion gjithashtu, mbi faktin se nuk ka asnjë ankim lidhur me këtë vendim nga ana e kandidatëve të skualifikuar dhe se afati ligjor për ushtrimin e së drejtës së ankimit kishte kaluar. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, në shkresë thuhet se rezulton që, magjistratët kandidatë për KED, plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara për këtë proces. Po kështu konfirmohet se prokurorët e propozuar për kandidatë, nuk rezultojnë se janë nën hetim dhe se, ata nuk janë dënuar më parë me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale.



Bazuar në konfirmimin zyrtar të dhënë prej Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ka rezultuar se ndaj prokurorëve kandidatë për anëtarë të KED, nuk janë vendosur sanksione administrative si dhe ndaj tyre nuk janë referuar kallëzime penale.

Në përgjigje të shkresës nr.4076/1 prot, datë 27.11.2020, që Sekretari i Përgjithshëm, i institucionit të Presidentit të Republikës, i ka drejtuar Kryetarit të KLGJ-së, evidentohet se në përputhje me detyrimin e saj ligjor, KLGJ-ja ka dërguar përgjigjen përkatëse pranë institucionit të Presidentit të Republikës. Nga verifikimi i kryer për këtë përgjigje të dhënë nga ana e KLGJ-së, rezulton se institucioni i Presidentit të Republikës ka vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për mospublikimin e saj, për shkak të statusit të sekretimit që ka kjo shkresë.

Nga ana tjetër, nuk është konstatuar publikimi nga ana e KLGJ-së, në faqen zyrtare të internetit të këtij organi, i listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore dhe listës së kandidatëve që nuk i plotësojnë kushtet ligjore, për të qënë kandidat në hedhjen e shortit për anëtar të KED-së<sup>3</sup>

Në përgjigjen e kthyer me shkresën nr. 2911/1 prot, datë 2.12.2020, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është dhënë informacioni se ky institucion ka kërkuar procedimin disiplinor për 2 (dy) gjyqtarë pranë KLGJ-së dhe procedim disiplinor për 1 (një) prokuror, pranë KLP-së.<sup>4</sup>

### ***3. Monitorimi i hedhjes së shortit***

Procesi i hedhjes së shortit për anëtarë të KED, ka filluar në orën 11.00'', të datës 4 Dhjetor 2020, në sallën "Skënderbej", në institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Në kushtet e respektimit të protokolleve shëndetësore dhe rregullave për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e Covid-19, në këtë sallë janë paraqitur dhe kanë qënë prezent përgjatë gjithë zhvillimit të procedurës të hedhjes së shortit, një numër i kufizuar personash. Kanë qënë prezent vetëm nga një përfaqësues nga disa institucione shtetërore, si Avokati i Popullit zj. Erinda Ballanca, përfaqësuesi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë z. Alfred Balla, përfaqësuesi i Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Maksim Qoku, përfaqësues nga Gjykata Kushtetuese z. Ermal Tauzi, Kuvendi i Shqipërisë zj. Mimoza Arbi, përfaqësues të OPDAT zj. Michelle Lakomy, si dhe ka patur përfaqësues vëzhgues nga Bashkimi Evropian (Komisioni Evropian) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Prezente ka qënë edhe media vizive (TVSH etj).

---

<sup>3</sup> Ky detyrim përcaktohet në pikën 4, të nenit 221, të ligjit 115/2016 "Për organet e sistemit të Drejtësisë"

<sup>4</sup> Sipas përmbajtjes së shkresës nr. 2911/1 prot, datë 2.12.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor i është përcjellë KLGJ-së, për magistratin Sh.M., gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe, magistratin M.K., gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Korçë. Po kështu, i është kërkuar KLP-së, fillimi i procedimit disiplinor ndaj magistratit E.K., prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Mbi bazën e autorizimit përkatës, në mungëse të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Meta, prezent në ambientin ku po zhvillohej shorti ka qënë Drejtori i Kabinetit të institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka qëndruar përgjatë gjithë zhvillimit të këtij procesi.

Veçori e zhvillimit të këtij procesi nga ana e institucionit të Presidentit të Republikës, ka qënë zbatimi në përputhje të plotë me bazën normative ligjore në fuqi, i të gjitha masave të nevojshme për parandalimin e infektimit nga Covid-19.

Në njoftimin përkatës drejtuar Avokatit të Popullit, me shkresën nr. 4076/2 prot., datë 27.11.2019, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, të institucionit të Presidentit të Republikës, është kërkuar pjesëmarrja nga ana e Avokatit të Popullit, në hedhjen e shortit për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me cilësinë e vëzhguesit të kësaj procedure.

Procesi i zhvillimit të shortit u facilitua nga ana e këshilltarit ligjor të Presidentit të Republikës, z. Bledar Dervishaj. Gjatë hapjes formale të procesit, z. Dervishaj bëri një prezantim të shkurtër të rëndësisë së KED-së, procedurave të krijimit të tij, përbërjes, kompetencave që i jepen nga Kushtetuta dhe nga legjislacioni në fuqi, si dhe të kriterëve ligjore që duhet të përmbushë çdo kandidat deri në momentin e hedhjes së shortit, për t'u përfshirë në këtë të fundit.

Pas verifikimit fizik të goglave plastike me të cilat do të hidhej shorti është kaluar në zhvillimin e procesit, për hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED.

Për hedhjen e shortit, mbi bazën e Vendimit nr.413 datë 25.11.2020, dhe të Autorizimit nr.4153/3 datë 4.12.2020, të nxjerrë nga ana e Presidentit të Republikës ishte krijuar një Sekretari Teknike, e caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm, i institucionit të Presidentit të Republikës, me përbërje të nëpunësve civilë të këtij institucioni.

Për këtë procedurë u përdorën disa enë qelqi transparente, ku ishin të vendosura goglat sipas numrit të kandidaturave të dërguara në shkresat përkatëse të institucioneve shtetërore propozuese. Ndërkohë u përdor një kuti transparente me mekanizëm rrotullues (e cila fillimisht ishte bosh), ku vendoseshin goglat në të cilat ishin futur shiritat e letrës të shënuara me emrat e kandidatëve të propozuar nga secili institucion, sipas listës përkatëse të përcjellë Presidentit të Republikës së Shqipërisë, prej tyre.

Fillimisht shiritat e letrës me emrat e kandidatëve sipas institucioneve përkatëse që merrnin pjesë në short, ishin vendosur në një kuti transparente të veçantë. Procesi teknik i hedhjes së shortit u facilitua edhe nga dy punonjëse të tjera të institucionit të Presidentit të Republikës, të cilat kryenin pikërisht veprimet e sipërcituara teknike.

Shiritat e letrës me emrat e kandidatëve, pasi u lexuan publikisht edhe në praninë e mediave u futën në gogla dhe rradha e hedhjes së shortit u përcaktua, duke u mbështetur në renditjen e mëposhtme:

- Kandidatë nga Gjykata Kushtetuese
- Kandidatë nga Gjykata e Lartë;
- Kandidatë nga Prokuroria e Përgjithshme.
- Kandidatë nga Gjykatat e Apelit;
- Kandidatë nga Zyrat e Prokurorisë, pranë Gjykatave të Apelit;
- Kandidatë nga Gjykatat Administrative.

1. Procedura e zhvillimit të shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykata Kushtetuese u zhvillua ndërmjet emrave të gjyqtarëve të kësaj gjykate, të konfirmuar në listën nominale, të dhënë në shkresën nr. 337 datë 13.11.2020, të anëtares me kompetencat e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, drejtuar Presidentit të Republikës. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykata e Kushtetuese (4 kandidatë sipas listës përkatëse), pas përzierjes së goglave nga një punonjëse e stafit të sekretariatit teknik, të institucionit të Presidentit të Republikës, goglat u tërhoqën në mënyrë rastësore nga stafi i sekretariatit apo nga të ftuar vëzhgues, sipas shprehjes së dëshirës prej tyre po në mënyrë rastësore, për këtë qëllim. Pasi u tërhoq emri i një kandidati, ky emër u lexua me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në sallë. Shiriti i letrës që gjendej brenda goglës së përzgjedhur, iu dorëzua Sekretariatit Teknik. Kandidati, i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet emrave të 4 (katër) gjyqtarëve, që plotësonin kushtet ligjore për të përfshirë në short, rezultoi se u përzgjodhën anëtarë të KED-së, përkatësisht:

- Zj. Marsida Xhaferllari (anëtar)
- Zj. Elsa Toska (anëtar)

Me të njëjtën procedurë shorti, u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, dhe më konkretisht;

- Zj. Fiona Papajorgji (anëtar zëvendësues).

2. Procedura e zhvillimit të shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykata e Lartë u zhvillua ndërmjet emrave të gjyqtarëve të kësaj gjykate, të konfirmuar në listën nominale, të dhënë në shkresën nr. 5811 prot, datë 13.11.2020, të Kryetarit të KLGJ, drejtuar Presidentit të Republikës. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykata e Lartë (3 kandidatë sipas listës përkatëse), pas përzierjes së goglave nga një punonjëse e stafit të sekretariatit teknik, të institucionit të Presidentit të Republikës, goglat u tërhoqën në mënyrë rastësore nga stafi

i sekretariatit apo nga të ftuar vëzhgues, sipas shprehjes së dëshirës prej tyre po në mënyrë rastësore, për këtë qëllim. Pasi u tërhoq emri i një kandidati, ky emër u lexua me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në sallë. Shiriti i letrës që gjendej brenda gogllës së përzgjedhur, iu dorëzua Sekretariatit Teknik. Kandidati, i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet emrave të 3 (tre) gjyqtarëve, që plotësonin kushtet ligjore për të përfshirë në short, rezultoi se u përzgjedhën anëtarë të KED-së, përkatësisht:

- Z. Ervin Pupe (anëtar)

Me të njëjtën procedurë shorti, u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, dhe më konkretisht;

- Z. Ilir Panda (anëtar zëvendësues).

3. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme (9 kandidatë nga Prokuroria e Përgjithshme) sipas listës përkatëse, të përcjellë në shkresën nr.1634 prot, datë 15.11.2019 të Kryetarit të KLP-së, drejtuar Presidentit të Republikës), pas përzierjes së goglave nga një punonjëse e stafit të sekretariatit teknik, të institucionit të Presidentit të Republikës, goglat u tërhoqën në mënyrë rastësore nga stafi i sekretariatit apo nga të ftuar vëzhgues, sipas shprehjes së dëshirës prej tyre po në mënyrë rastësore, për këtë qëllim. Pasi u tërhoq emri i një kandidati, ky emër u lexua me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në sallë. Shiriti i letrës që gjendej brenda gogllës së përzgjedhur, iu dorëzua Sekretariatit Teknik. Kandidati, i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet emrave të 11 prokurorëve që plotësonin kushtet ligjore për të përfshirë në short, rezultoi se u përzgjedhën anëtarë të KED-së:

- Z. Adnan Xholi (anëtar)

Me të njëjtën procedurë shorti, u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme, dhe më konkretisht;

- Z. Kujtim Luli (anëtar zëvendësues).

4. Procedura e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykatat e Apelit u zhvillua ndërmjet emrave të gjyqtarëve të këtyre gjykateve, të konfirmuar në listën nominale, të dhënë në shkresën nr. 5811 prot. datë 13.11.2019, të Kryetarit të KLGJ-së, drejtuar Presidentit të Republikës. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykatat e Apelit (36 kandidatë sipas listës përkatëse), pas përzierjes së goglave nga një punonjëse e stafit të sekretariatit teknik, të institucionit të Presidentit të Republikës, goglat u tërhoqën në mënyrë rastësore nga stafi i sekretariatit apo nga të ftuar vëzhgues,

sipas shprehjes së dëshirës prej tyre po në mënyrë rastësore, për këtë qëllim. Pasi u tërhoq emri i një kandidati, ky emër u lexua me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në sallë. Shiriti i letrës që gjendej brenda gogllës së përzgjedhur, iu dorëzua Sekretariatit Teknik. Kandidati, i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet emrave të 36 gjyqtarëve që plotësonin kushtet ligjore për të përfshirë në short, rezultoi se u përzgjedh anëtar i KED-së:

- Z. Astrit Kalaja (anëtar)
- Zj. Elona Toro (anëtar)

Me të njëjtën procedurë shorti u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, gjyqtarë të Gjykatave të Apelit, dhe më konkretisht;

- Zj. Zegjine Sollaku (anëtar zëvendësues)

5. Procedura e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit, u zhvillua ndërmjet emrave të prokurorëve, të konfirmuar në listën nominale, të dhënë në shkresën nr.1634 prot, datë 16.11.2020 të Kryetarit të KLP, drejtuar Presidentit të Republikës. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit (9 kandidatë sipas listës përkatëse), pas përzierjes së goglave nga një punonjëse e stafit të sekretariatit teknik, të institucionit të Presidentit të Republikës, goglat u tërhoqën në mënyrë rastësore nga stafi i sekretariatit apo nga të ftuar vëzhgues, sipas shprehjes së dëshirës prej tyre po në mënyrë rastësore, për këtë qëllim. Pasi u tërhoq emri i një kandidati, ky emër u lexua me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në sallë. Shiriti i letrës që gjendej brenda gogllës së përzgjedhur, iu dorëzua Sekretariatit Teknik. Kandidati, i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet emrave të 9 (nëntë) prokurorëve që plotësonin kushtet ligjore për të përfshirë në short, rezultoi se u përzgjedh anëtar i KED-së:

- Z. Gjon Fusha (anëtar)
- Z. Genti Xholi (anëtar)

Me të njëjtën procedurë shorti, u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, prokuror në Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit, dhe më konkretisht;

- Z. Kleanth Zeka (anëtar zëvendësues)

6. Procedura e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykatat Administrative u zhvillua ndërmjet emrave të gjyqtarëve, të konfirmuar në listën nominale, të dhënë në shkresën nr. 5811 prot. datë 13.11.2019, të Kryetarit të KLGJ-së, drejtuar Presidentit të

Republikës. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykatat Administrative (28 kandidatë sipas listës përkatëse), pas përzierjes së goglave nga një punonjëse e stafit të sekretariatit teknik, të institucionit të Presidentit të Republikës, goglat u tërhoqën në mënyrë rastësore nga stafi i sekretariatit apo nga të ftuar vëzhgues, sipas shprehjes së dëshirës prej tyre po në mënyrë rastësore, për këtë qëllim. Pasi u tërhoq emri i një kandidati, ky emër u lexua me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në sallë. Shiriti i letrës që gjendej brenda gogllës së përzgjedhur, iu dorëzua Sekretariatit Teknik. Kandidati, i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet emrave të 28 (njëzet e tetë) gjyqtarëve që plotësonin kushtet ligjore për tu përfshirë në short, rezultoi se u përzgjodh anëtar i KED-së:

- Zj. Rilinda Selimi (anëtar)

Me të njëjtën procedurë shorti, u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, gjyqtar në Gjykatat Administrative, dhe më konkretisht;

- Zj. Gentiana Xhelili (anëtar zëvendësues)

Sipas përkatësisë së hedhjes së shortit referuar institucionit nga vinin kandidatët garues, për audiencën që ndiqte këtë procedurë shfaqej paraprakisht në një ekran të madh elektronik, lista e kandidatëve të propozuar që plotësonin kushtet ligjore për të përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të KED.

Në përfundim të këtij procesi, u përzgjodhën 9 (nëntë) anëtarë të KED, dhe 6 (gjashtë) anëtarë zëvendësues. Kjo është hera e parë në të cilën KED është në përbërje të plotë, si në numër anëtarësh, ashtu edhe në numër anëtarësh zëvendësues duke realizuar në këtë mënyrë parashikimin ligjor. Një gjë e tillë u arrit pas ndryshimeve ligjore por edhe pas plotësimit të numrit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

Në përputhje me pikën 6, të nenit 284, të ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, në faqen zyrtare të internetit, të institucionit të Presidentit të Republikës, është publikuar edhe një përmbledhje e procesverbalit, për hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për vitin 2021.<sup>5</sup>

Hedhja e shortit është transmetuar direkt nga ana e Televizionit Publik Shqiptar, si dhe media të tjera, prezente në ambientin ku po zhvillohej hedhja e shortit.

---

<sup>5</sup> <https://president.al/shortii-per-ked-2021/>

Gjithashtu, në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës, si një tregues maksimal i transparencës, gjendet e publikuar e gjitha korrespondenca zyrtare e mbajtur me institucionet e tjera shtetërore, që kanë detyrimin e dërgimit të listave të kandidatëve për anëtarë të KED-së, pranë tij, si dhe të gjitha aktet normative rregullatore të nxjerra nga ky institucion për mbarëvajtjen e procesit të hedhjes së shortit.

Në kuadër të rritjes së transparencës të këtij procesi, përkundër shembullit të institucionit të Presidentit të Republikës, rekomandojmë që edhe gjithë institucionet e tjera shtetërore të përfshira në të, të publikojnë në faqet e tyre zyrtare të internetit korrespondecat përkatëse, zyrtare, të mbajtura me Presidentin e Republikës, si dhe çdo akt tjetër normues rregullator që ata mund të nxjerrin në funksion të përmbushjes së detyrimeve të tyre ligjore, për procesin e hedhjes së shortit për anëtarë të KED-së.

Megjithëse nuk përbën një detyrim ligjor në tërësinë e saj, kjo praktikë e mirë e zhvillimit të transparencës, kërkon vetëm vullnet të mirë administrativ dhe një konsiderim specifik të së drejtës për informim, në funksion të interesit të gjerë publik për zhvillimin e këtij procesi.

Në përfundim të hedhjes së shortit, u shpallën emrat e anëtarëve të KED, të përzgjedhur nga shorti, si dhe emrat e anëtarëve zëvendësues, si vijon:

#### **Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi:**

- |                            |  |
|----------------------------|--|
| 1. Zj. Marsida Xhaferllari | nga Gjykata Kushtetuese                          |
| 2. Zj. Elsa Toska          | nga Gjykata Kushtetuese                          |
| 3. Z. Ervin Pupe           | nga Gjykata e Lartë                              |
| 4. Z. Adnan Xholi          | nga Prokuroria e Përgjithshme                    |
| 5. Z. Astrit Kalaja        | nga Gjykatat e Apelit                            |
| 6. Zj. Elona Toro          | nga Gjykatat e Apelit                            |
| 7. Z. Gjon Fusha           | nga Zyra e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit |
| 8. Z. Genti Xholi          | nga Zyra e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit |
| 9. Zj. Rilinda Selimi      | nga Gjykatat Administrative                      |

#### **Anëtarët zëvendësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi**

- |                         |                               |
|-------------------------|-------------------------------|
| 1. Zj. Fiona Papajorgji | nga Gjykata Kushtetuese       |
| 2. Z. Ilir Panda        | nga Gjykata e Lartë           |
| 3. Z. Kujtim Luli       | nga Prokuroria e Përgjithshme |
| 4. Zj. Zegjine Sollaku  | nga Gjykata e Apelit          |

5. Z. Kleanth Zeka
6. Zj. Gentjana Xhelili

nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit  
nga Gjykatat Administrative.

**AVOKATI I POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**